



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr..... Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

13302

UDHEZIM

Nr. 29, datë 29.12.2017

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 12.7.2013 "PËR PROCEDURAT E POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LICENCË TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE PLOTËSUESE PRIVATE PARAUNIVERSITARE"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 15, 16, pika 4, neni 17 pika 3, germa "d" dhe neni 20 të ligjit Nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit nr. 538, datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 4 të Kreut I, të udhëzimit nr.15, datë 12.7.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licence të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", gjerat "b", "c" "e" dhe "f", shfuqizohen.
2. Në pikën 4 të Kreut I, të udhëzimit nr.15, datë 12.7.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licence të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", gjerma "g", ndryshon si më poshtë:
g. Shtojcën nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi."
3. Ngarkohen për zbatimin e kërrij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



Shtojca 1

KËRKESË PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE PLOTËSUESE PRIVATE PARAUNIVERSITARE

Institucioni arsimor privat parauniversitar: _____

Kërkuesi i licencës: _____

Vendodhja: _____

Adresa elektronike e institucionit: _____

Numër kontakti: _____

I. AUTODEKLARIM

Ne/ Unë i/ e nënshkruari/ a _____

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Të gjithë të dhënat janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë penale në rast dhënie informacioni të pavërtetë, si dhe pranoj t'i nënshtrohem verifikimit nga organet përkatëse për të gjithë informacionin e paraqitur si më poshtë:

1. Subjekti që aplikon për licencë, garanton se drejtuesi didaktik dhe personeli mësimdhënës disponojnë dokumentacionin arsimor (diplomë, listë notash, licencë për ushtrimin e profesionit) në përputhje me profilin e lëndës përkatëse.
2. Subjekti që aplikon për licencë disponon kontratën e punës me kohë të plotë ndërmjet tij dhe drejtuesit didaktik.
3. Subjekti që aplikon për licencë, garanton zbatimin e kurrikulës zyrtare (Plane mësimore, programe lëndore dhe tekste mësimore) të miratuara nga MASR.
4. Subjekti që aplikon për licencë, garanton listë të plotë të stafit drejtues dhe mësimdhënës me ngarkesën mësimore përkatëse.
5. Subjekti që aplikon për licencë, garanton bazën materiale dhe atë didaktike që do të vihet në dispozicion (inventarin përkatës) dhe që është në funksion të arsimit, edukimit dhe realizimit të kërkesave të programeve lëndore.

Subjekti

Data _____

Firma,